

20121714024

**L I G J**  
**PËR HUAMARRJE TË REPUBLIKES SË MAQEDONISE TE DOJCE BANKA SIPAS**  
**MARREVESHJES PËR HUA TË SIGURUAR ME GARANCI TË BAZUAR NË**  
**POLITIKA TË BANKES NDERKOMBETARE PËR RINDERTIM DHE ZHVILLIM-**  
**BANKES BOTERORE**

Neni 1

Republika e Maqedonise merr hua te Dojce Banka të siguruar me garanci të bazuar në politika të Bankes Nderkombetare për Rindertim dhe Zhvillim-Bankes Boterore në shume prej 250 000 000 euro.

Neni 2

Kushtet dhe menyra e shfrytezimit të huas nga neni 1 i ketij ligji, percaktohen me Marreveshje për hua të siguruar me garanci që do të lidhet ndermjet Republikes së Maqedonise, Dojce Bankes dhe Bankes Nderkombetare për Rindertim dhe Zhvillim-Bankes Boterore.

Në emer të Republikes së Maqedonise, Marreveshjen për hua nga paragrafi 1 i ketij neni, do ta nenshkruaje ministri i Financave.

Neni 3

Kushtet dhe menyra e aktivizimit të garancise nga neni 1 i ketij ligji, percaktohen me Marreveshje për garanci që do të lidhet ndermjet Republikes së Maqedonise dhe Bankes Nderkombetare për Rindertim dhe Zhvillim-Bankes Boterore.

Në emer të Republikes së Maqedonise, Marreveshjen për garanci nga paragrafi 1 i ketij neni do ta nenshkruaje ministri i Financave.

Neni 4

Huaja nga neni 1 i ketij ligji do të paguhet në dy keste, nga të cilat kesti i pare në shume prej 95 000 000 euro do të paguhet në ditën e maturimit që bie pese vite nga dita e terheqjes së mjeteve të huas, ndersa kesti i dyte në shume prej 115 000 000 euro do të paguhet në ditën e maturimit që bie shtate vite nga dita e terheqjes së mjeteve.

Shkalla e kamates do të percaktohet si shkalle fikse e kamates dy dite para dites së terheqjes së mjeteve të huas nga neni 1 i ketij ligji, e do të llogaritet si shume e mesit aritmetik të svopit pesevjecar dhe shtatevjecar (për valute euro) plus margjina në shume prej 2,75%. Shpenzimet e kamates do të paguhen në gjysmevjeter.

Në ditën e terheqjes së mjeteve të huas nga neni 1 i ketij ligji, Republika e Maqedonise do t'i paguaje Bankes Nderkombetare për Rindertim dhe Zhvillim-Bankes Boterore provizion të njehershem në shume prej 0,25% të shumës së garancise së dhene dhe provizion të njehershem në shume prej 0,5% në vit të shumës së garancise së dhene, të llogaritur me vlere diskontimi për kohezgjatjen e garancise.

Në ditën e terheqjes së mjeteve të huas nga neni 1 i ketij ligji, Republika e Maqedonise do t'i paguaje Dojce Bankes provizion të njehershem në shume prej 1,50% të shumës së huas.

Neni 5

Shfrytezues i mjeteve të huas nga neni 1 i ketij ligji eshte Ministria e Financave.

Neni 6

Republika e Maqedonise huan nga neni 1 i ketij ligji do ta paguaje nga Buxheti i Republikes së Maqedonise.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazeten Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".